



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada – Government*  
*Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansija – Ministry of Finance*  
***Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo -Tax Administration of Kosovo***

# **Tatimi mbi Vlerën e Shtuar – TVSH** ***Çka duhet të dini?!***

**Nëntor, 2011**

## Përmbajtja

Misioni ynë.....	4
Në Lidhje Me Këtë Udhëzues.....	5
Para se të filloni .....	6
Dispozitat e Përgjithshme .....	7
Çka është TVSH-ja? .....	7
Cilat janë normat tatimore?.....	7
Kush duhet t’i nënshtrohet këtij ligji?.....	7
Kush duhet ta vjelë TVSH-në dhe kur?.....	7
Si dhe kur të regjistroheni për certifikatë të TVSH-së?.....	8
Si dhe kur të ç’regjistroheni nga TVSH-ja?.....	8
Si dhe kur të aplikoni për certifikatë eksporti / import .....	8
Personat e tatueshëm.....	10
Regjistrimi i Obligueshëm – Kush është i obliguar të deklaroj TVSH-në?.....	10
Regjistrimi Vullnetar – Kush nuk është i obliguar, por mund të regjistrohet vullnetarisht? .....	10
Personat e punësuar.....	10
Autoritetet e nivelit qendror dhe lokal.....	10
Organet e organizatave Ndërkombëtare.....	10
Personat Fizik .....	11
Ortakëria apo grupimi i personave .....	11
Personat që nuk janë të vendosur në Kosovë.....	11
Qiradhënësit .....	11
Importuesit e vegjël .....	11
Kompanitë Ndërtimore .....	12
Lirimet .....	13
Rabatet.....	13
Zbritjet.....	14
E drejta dhe mënyra për të zbritur TVSH-në.....	14
Rimbursimi .....	14
Çka është dhe si lind?.....	14
Procedurat për rimbursim të TVSH-së .....	14
Kur mund të pritni rimbursimin? .....	15
Faturimi dhe dokumente tjera tatimore.....	16
Përmbajtja e një fature .....	16
➤ Personi i tatueshëm për personin tjetër të tatueshëm .....	16
➤ Person i tatueshëm për personin tjetër JO TË TATUESHËM.....	17
Kuponët fiskal .....	17

Notat e debitit dhe kreditit .....	17
Çka janë? .....	17
Çka duhet të përmbajnë? .....	18
Fatura e borxhit të keq.....	18
Çka është borxhi i keq? .....	18
Çfarë duhet të përmbajë fatura e borxhit të keq?.....	18
Mbajtja dhe ruajtja e librave të TVSH-së .....	19
Çka duhet të përmbajë libri i blerjeve?.....	19
Çka duhet të përmbajë libri i shitjeve? .....	19
Periodha e ruajtjes së librave.....	19
Deklarata Tatimore kuti për kuti.....	20
Si të plotësohet? .....	20
Si ti shmangemi gabimeve dhe vonesave .....	20
Kur duhet të deklaroni? .....	28
Pasi ta dorëzoni deklaratën tatimore .....	29
Çfarë ndodh me deklaratën pasi të pranohet?.....	29
Cilat janë ndëshkimet dhe interesi që aplikohet? .....	29
Të drejtat e juaja .....	30
Obligimet e juaja .....	30
Çfarë nëse ju auditoheni? .....	31
Kur do të më vizitojë një inspektor tatimor? .....	31
Ku të drejtoheni për ndihmë.....	32
Sigurimi i informatave për tatimin tuaj.....	32
Pyetje dhe Shembuj praktik .....	33
Shtojcat .....	37

## Misioni ynë...

- **Maksimizimi i përmbushjes vullnetare**, duke i kushtuar rëndësi legjilacionit tatimor.
- **Ofrimi i shërbimeve profesionale, transparente dhe efikase për komunitetin e tatimpaguesve në mënyrë që ata të kuptojnë obligimet e tyre tatimore, dhe**
- **Sigurimi i aplikimit të barabartë dhe fuqizimi i legjislacionit tatimor me qëllim që të mblidhen të hyra për buxhetin e Kosovës në një mënyrë efikase dhe me kosto të ulët**

ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS

## Në Lidhje Me Këtë Udhëzues

Ky udhëzues është pregaditur për t'i asistuar tatimpaguesve që deklarojnë Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, në mënyrë që ta kenë më lehtë deklarin e TVSH-së dhe respektimin e ligjit të TVSH-së. Ky udhëzues është i shkruar në mënyrë të thjeshtë, me shembuj të kuptueshëm dhe nuk është dokument ligjor, por ka qëllim të përdoret vetëm si udhëzues.

### Shkurtime e Shpesha

UA	Udhëzim Administrativ
BQK	Banka Qëndrore e Kosovës
TVSH	Tatimi mbi vlerën e shtuar
NF	Numri Fiskal
PF	Pasyra financiare
TRUST	Trusti pensional I Sigurimeve të Kosovës
OJQ	Organizatë jo-qeveritare
TAP	Tatimi në të ardhurat personale
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës

***Para se të filloni ...***

- Lexoni këtë udhëzues me kujdes. Do t'ju ndihmojë t'i shmangni gabimet.
- Nëse keni nevojë për më shumë informacione, rishikoni ligjet dhe udhëzimet përkatëse administrative, të disponueshme në faqen e internetit të ATK-së ([www.atks.org](http://www.atks.org)) nën lidhësen *Legjislacioni*. Ato përfshijnë:
  - Ligji nr 03/L-146 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar
  - Udhëzimet Administrative Nr 10 / 2010 dhe 15/2010
  - Ligji Nr 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat
  - Ju mund të gjeni edhe informata të dobishme në seksionin *Pyetjet më Shpesh të Pyetura* në faqen e internetit të ATK.-së
- Nëse ju nuk mund t'i gjeni përgjigjet e pyetjeve tuaja, ju mund të kontaktoni ATK-në. Kapitulli i fundit i këtij udhëzuesi shpjegon se si të bëhet kjo (faqe 32).

## Dispozitat e Përgjithshme

### ***Çka është TVSH-ja?***

Tatimi mbi vlerën e shtuar – TVSH, përfshin aplikimin e tatimit të përgjithshëm në konsum për mallra dhe shërbime, që është saktësisht proporcional me çmimin e mallrave dhe shërbimeve. TVSH llogaritet në këtë çmim sipas normës së aplikueshme, ngarkohet në fazat e ndryshme të prodhimit, shpërndarjes dhe ciklit jetësor të tregtisë së mallrave dhe shërbimeve, dhe në fund i ngarkohet konsumatorit.

### ***Cilat janë normat tatimore?***

Normat tatimore ndahen në:

- Norma standarde ku TVSH ngarkohet me normën prej 16 %.
- Norma e ulur ku TVSH ngarkohet me normën prej 5%<sup>1</sup> (ende nuk aplikohet)
- Norma e lartë ku TVSH ngarkohet me normën prej 21%<sup>2</sup> (ende nuk aplikohet)

### ***Kush duhet t'i nënshtrohet këtij ligji?***

Secili person i cili zhvillon një aktivitet të pavarur ekonomik (prodhim, tregëti apo kryen shërbime të ndryshme) në Kosovë dhe kur qarkullimi në 12 muajt e fundit tejkalon pragun prej 50,000 € duhet të regjistrohet për TVSH dhe të deklarojë atë në bazë të periudhave të caktuara tatimore.<sup>3</sup>

### ***Kush duhet ta vjelë TVSH-në dhe kur?***

TVSH-në kanë të drejtë ta vjelin vetëm tatimpaguesit e regjistruar si deklarues të TVSH-së (me kalimin e pragut prej 50,000 € ose të regjistruar në mënyrë vullnetare) dhe atë në momentin e shitjes së mallrave apo shërbimeve. Momenti i lindjes së detyrimit dhe ngarkimi me TVSH-së paraqitet në njërin nga rastet e mëposhtme, cilido ndodh i pari:

- Kur lëshohet faktura
- Kur malli dorëzohet klientit ose kryhet shërbimi ndaj tij
- Kur të merret pagesa

---

<sup>1</sup> Kjo normë mund të aplikohet në rastet kur Ministri i Financave me vendimin e Qeverisë së Kosovës dhe aprovimin nga Kuvendi, nxjerr një akt nën-ligjor për futjen në përdorim të kësaj norme.

<sup>2</sup> E njejtë me parapraken, nr. 1

<sup>3</sup> Shih fq 8 për informata të detajuara për regjistrim të TVSH-së dhe faqe 27 për info të periudhave tatimore

### ***Si dhe kur të regjistroheni për certifikatë të TVSH-së?***

Në rastet kur ju keni kaluar pragun prej 50,000 €, duhet të paraqiteni në zyrën tuaj regjionale të ATK-së dhe të plotësoni formularin për t'u regjistruar për certifikatë të TVSH-së.<sup>4</sup> Ju duhet të sillni me vete edhe një kopje të dokumenteve për regjistrim të biznesit, Certifikatën e Numrit Fiskal dhe dokumentin identifikues zyrtar me fotografi (pasaportë, letërnjoftim, etj.)

Me këtë rast ATK do të shqyrtojë kërkesën tuaj (formularin dhe dokumentet e lartëshënura) dhe në momentin kur kërkesa juaj pranohet ATK do t'ua lëshoj certifikatën e regjistrimit të TVSH-së e cila përmban emrin, numrin e tuaj fiskal dhe numrin unik të regjistrimit për TVSH si dhe adresën apo adresat ku zhvillon aktivitetin e biznesit.<sup>5</sup>

Nëse ATK zbulon se tatimpaguesi nuk është i rregullt në të gjitha obligimet tatimore apo se informatat në formularin e regjistrimit nuk janë të sakta, ATK do t'i dërgoj një njoftim me shkrim tatimpaguesit se certifikatat e TVSH-së nuk mund të lëshohet.

***E rëndësishme:*** Mos harroni që kopjen e vërtetuar të certifikatës së TVSH-së, ta ekspozoni aty ku mund të shihet dhe lexohet lehtë nga publiku.

### ***Si dhe kur të ç'regjistroheni nga TVSH-ja?***

Nëse ju jeni të regjistruar për TVSH dhe furnizimet totale gjatë 12 muajve të fundit kanë qenë nën pragun prej 50,000 €, ju mund të bëni kërkesë për ç'regjistrim hyn në fuqi në momentin kur ATK vërteton se furnizimet tuaja totale gjatë 12 muajve të fundit nga data e parashtrimit të kërkesës, kanë qenë nën pragun prej 50,000 €.

Nëse ju shuani aktivitetin tuaj, ju duhet që brenda 15 ditësh të lajmëroheni në ATK dhe të njoftoni zyrtarët për këtë çështje si dhe të kërkonti të ç'regjistroheni. Ç'regjistrimi hyn në fuqi në ditën e pushimit të aktivitetit.

### ***Si dhe kur të aplikoni për certifikatë eksporti / import***

Nëse ju jeni të përfshirë në aktivitete ekonomike, **nuk** jeni të regjistruar për TVSH dhe dëshironi të zhvillonit aktivitete eksporti apo importit, jeni të obliguar që **para** se të filloni të zhvillonit këto aktivitete të njoftoni ATK-në dhe të kërkonti certifikatën për këtë aktivitet.

Ajo se çka ju duhet të bëni është, të paraqiteni në zyrën tuaj regjionale të ATK-së, të plotësoni formularin<sup>6</sup> për t'u regjistruar për certifikatë të eksportit dhe importit dhe duhet

<sup>4</sup> Ju mund të gjeni formularin edhe nëse ndiqni këtë vegëz, [http://apps.atk-ks.org/edeclarations/PDFTemplates/FRTVSH\\_sq-AL.pdf](http://apps.atk-ks.org/edeclarations/PDFTemplates/FRTVSH_sq-AL.pdf)

<sup>5</sup> Shih Shtojcën 1 për të parë se si duket certifikata e TVSH-së

<sup>6</sup> Ju mund të gjeni formularin edhe nëse ndiqni këtë vegëz, [http://apps.atk-ks.org/edeclarations/PDFTemplates/IMPOEXPO\\_sq-AL.pdf](http://apps.atk-ks.org/edeclarations/PDFTemplates/IMPOEXPO_sq-AL.pdf)

të sillni me vete edhe një kopje të dokumenteve për regjistrim të biznesit, Certifikatën e Numrit Fiskal dhe dokumentin identifikues zyrtar me fotografi (pasaportë, letërnjoftim, etj.)

Me këtë rast ATK do të shqyrtojë kërkesën tuaj (formularin dhe dokumentet e lartëshënura) dhe në momentin kur kërkesa juaj pranohet ATK do t'ua lëshoj certifikatën për eksport dhe import cila përmban emrin, numrin e tuaj fiskal dhe numrin unik të certifikatës së eksportit dhe importit si dhe adresën apo adresat ku zhvilloni aktivitetin.<sup>7</sup>

Nëse ATK vlerëson se nuk jeni aktual në të gjitha parashtrimet e deklarimeve apo pagesave të tatimeve, nuk do t'ua lëshoj certifikatë importit/eksportit deri në kohën kur të bëheni aktual në të gjitha çështjet tatimore.

Ju duhet të aplikoni për këtë certifikatë në rastet kur:

- importoni mallra në Kosovë dhe nuk jeni të regjistruar për TVSH
- eksportoni mallra nga Kosova dhe nuk jeni të regjistruar për TVSH

***E rëndësishme:*** Nëse posedoni certifikatë të TVSH-së nuk keni nevojë të pajiseni me certifikatë eksporti/importi për të zhvilluar këtë veprimtari.

---

<sup>7</sup> Shih Shtojcën 2 për të parë se si duket certifikata e eksportit dhe importit

## Personat e tatueshëm

### ***Regjistrimi i Obligueshëm – Kush është i obliguar të deklaroj TVSH-në?***

Secili person i cili zhvillon një aktivitet ekonomik (prodhim, tregëti apo kryen shërbime të ndryshme) në Kosovë në mënyrë të rregullt apo jo të rregullt, pavarësisht nga qëllimi ose rezultati i atij aktiviteti ekonomik dhe kur qarkullimi në 12 muajt e fundit tejkalon pragun prej 50,000 € duhet të regjistrohet për certifikatë të TVSH-së dhe të deklarojë atë në bazë të periudhave të caktuara tatimore.<sup>8</sup>

### ***Regjistrimi Vullnetar – Kush nuk është i obliguar, por mund të regjistrohet vullnetarisht?***

Personat e përfshirë në aktivitet ekonomik që kanë qarkullim nën limitin e përcaktuar 50.000 €, nuk janë të obliguar të regjistrohen si deklarues të TVSH-së, mirëpo nëse ata dëshirojnë, mund të regjistrohen si deklarues vullnetar. Nga momenti kur ata bëhen persona të tatueshëm në mënyrë vullnetare, i marrin të drejtat dhe përgjegjësitë si çdo deklarues i TVSH-së.

### ***Personat e punësuar***

Personat e punësuar apo personat tjerë, që janë të lidhur me punëdhënës nëpërmes kontratës së punësimit ose me ndonjë detyrim tjetër ligjor që krijon marrëdhënien punëdhënës i punësuar dhe ka të bëjë me: kushtet e punës, pagesën dhe përgjegjësitë e punëdhënësit – nuk kërkohet të regjistrohen për TVSH.

### ***Autoritetet e nivelit qendror dhe lokal***

Autoritetet e nivelit qendror dhe lokal dhe organet tjera të rregulluara me ligj, nuk duhet të konsiderohen si persona të tatueshëm në lidhje me aktivitetet ose transaksionet në të cilat angazhohen si autoritete publike, edhe atëherë kur mbledhin taksa, kontribute ose pagesa në lidhje me ato aktivitete ose me ato transaksione.

### ***Organet e organizatave Ndërkombëtare***

Organet e organizatave Ndërkombëtare, Shtetet e huaja dhe agjencionet e tyre nuk duhet të konsiderohen si persona të tatueshëm në lidhje me aktivitetet ose transaksionet në të cilat angazhohen si autoritete publike, edhe atëherë kur mbledhin taksa, kontribute ose pagesa

---

<sup>8</sup> Shih fq 8 për më shumë info rreth regjistrimit për certifikatë të TVSH-së

në lidhje me ato aktivitete ose me ato transaksion edhe nëse ato pranojnë pagesa në lidhje me këto aktivitete.

Mirëpo agjencionet e shteteve të huaja duhet të konsiderohen si persona të tatueshëm në lidhje me ato aktivitete ose transaksione kur trajtimi i tyre në shtetin e tyre mundë të qonte në konsiderimin e këtyre aktiviteteve sikur janë zhvilluar nga personi i tatueshëm.

### ***Personat Fizik***

Personi fizik që zhvillon disa aktivitete ekonomike në Kosovë (konsulencë, qiradhënie, shërbime të tjera) duhet të regjistrohet dhe deklarojë TVSH-në që nga momenti kur ai person kalon pragun e qarkullimit prej 50 000 €. Ai duhet të ndjek procedurat e rregullta për t'u regjistruar për certifikatë të TVSH-së.<sup>9</sup>

### ***Ortakëria apo grupimi i personave***

Mënyra e përmbushjes së obligimeve dhe ushtrimi i të drejtave të përcaktuara me Ligjin e TVSH-së nuk ndryshojnë për Ortakërinë apo grupimin e personave, ato janë të njëjta si për të gjitha entitete - pra Ortakëria apo grupimi i personave duhet të regjistrohet dhe deklarojë TVSH-në në momentin kur kalon pragun e qarkullimit prej 50 000 €. Për përmbushjen e obligimeve dhe ushtrimin e të drejtave të përcaktuara me Ligjin e TVSH-së, ortakët apo grupimi i personave duhet të caktojë një ortak apo person të përgjithshëm si përfaqësues të tyre.

### ***Personat që nuk janë të vendosur në Kosovë***

Personat të cilët nuk janë të vendosur në Kosovë, duhet të regjistrohen për TVSH nga fillimi i zhvillimit të aktiviteteve ekonomike në Kosovë – pa marrë parasysh pragun prej 50,000 €.

### ***Qiradhënësit***

Nëse ju jeni Qiradhënës (pronar i objektit të lëshuar me qira) dhe nëse të hyrat vjetore nga qiraja kalojnë 50 000 €, ju duhet të ndiqni rregullat e regjistrimit dhe deklarimit të TVSH-së ashtu siç është paraparë me legjislacion.<sup>10</sup>

### ***Importuesit e vegjël***

Për të kryer importe ju duhet të regjistroheni për certifikatë eksporti/importi<sup>11</sup> apo të jeni të regjistruar për TVSH. Me rastin e importimit ju ngarkoheni me TVSH kur bëhet

<sup>9</sup> Shih fq 8 për më shumë info rreth regjistrimit për certifikatë të TVSH-së

<sup>10</sup> Shih fq 8 për më shumë info rreth regjistrimit për certifikatë të TVSH-së

<sup>11</sup> Shih fq 8 për më shumë info rreth regjistrimit për certifikatë të eksportit/importit

zhdoganimi i mallrave por nuk keni për obligim të deklaroni TVSH-në. Gjithashtu ju rikujtojmë nuk keni të drejtë të kreditimit të TVSH-së ta paguar në importe apo në blerje vendore.

### ***Kompanitë Ndërtimore***

Mënyra e përmbushjes së obligimeve dhe ushtrimi i të drejtave të përcaktuara me Ligjin e TVSH-së nuk ndryshojnë për Kompanitë Ndërtimore, ato janë të njëjta si për të gjitha entitete - pra Kompania Ndërtimore duhet të regjistrohet dhe deklarojë TVSH-në momentin kur kalon pragun e qarkullimit prej 50 000 €.

Duhet të theksohet se objektet banesore janë të përjashtuara nga TVSH, ndërsa për lokalet afariste në kuadër të objektit banesor të ndërtuara nga e njëjta kompani duhet të ngarkohet TVSH-ja.

## Lirimet

TVSH nuk duhet të të paguhet për transaksionet në vijim duke mos u kufizuar në to:

- importimin e sendeve personale të udhëtarit të lejuara sipas dispozitave doganore në fuqi;
- importin e mallrave turistike të lejuara nga dogana sipas dispozitave në fuqi të Doganës;
- importet ose furnizimet e financuara nga donacionet e bëra përmes Ministrive dhe Departamentet qeveritare, organizatat qeveritare, organizatat joqeveritare me status të beneficuar publik si ndihmat për programet humanitare dhe rindërtimin e Kosovës;
- importet ose hyrjet të cilat i kanë bërë përfaqësuesit diplomatikë ose janë bërë për ta apo për zyret e ndërlidhjes;
- importet apo hyrjet brenda të cilat i kanë bërë Kombet e Bashkuara ose janë bërë për to apo për cilindo nga organet e saj, duke përfshirë UNMIK-un, agjencitë e specializuara të Kombeve të Bashkuara, KFOR-in, Bankën Botërore dhe organizatat ndërkombëtare ndërqeveritare ;
- importet apo hyrja e barnave brenda, shërbimet spitalore dhe kujdesi mjekësor, produktet farmaceutike, instrumentet mjekësore apo kirurgjike
- gjobitja me para ose dënimi i bërë nga autoritetet publike;
- furnizimi i barnave, i shërbimet mjekësore, i produkteve farmaceutike, i instrumenteve mjekësore apo pajisjeve kirurgjike;
- furnizimet e shërbimeve të arsimimit publik dhe privat;
- furnizimet e shërbimeve financiare;
- transferimi i titullit të pronësisë, qiraja e tokës dhe e shtëpive të banimit;
- sigurimi i lejeve ose licencave bashkë me pagesën nga organet komunale ose publike.

## Rabatet

Në rastet kur personat e poshtëshënuar importojnë ndonjë mall, ATK-ja do t'ia kthejë personit paratë në masën e cila është e barazvlefshme me TVSH-në të cilin ai person e ka paguar për atë import apo futje të atij malli. Kjo rregull vlen për:

- Kontraktuesit e UNMIK-ut,
- Agjencitë e specializuara të Kombeve të Bashkuara;
- KFOR-in;
- Bankën Botërore dhe

➤ Organizatat ndërkombëtare ndërqeveritare

Që ATK t'ia kthej personit në fjalë paratë e TVSH-së, ai person duhet të sjell në ATK dëshminë se mallrat e sjellur në Kosovë do të shfrytëzohen vetëm për qëllime të përmbushjes së kontratës me UNMIK-un, agjencitë e specializuara të Kombeve të Bashkuara, KFOR-in, Bankën Botërore ose me organizatat ndërkombëtare ndërqeveritare.

## Zbritjet

### ***E drejta dhe mënyra për të zbritur TVSH-në***

TVSH-ja e zbritshme<sup>12</sup> lind në kohën kur TVSH bëhet e ngarkueshme<sup>13</sup>. Personi i tatueshëm mund të zbres nga obligimet e tij të TVSH-së, TVSH-në e paguar në lidhje me blerjet e mallrave dhe shërbimeve. Ai bën zbritjen duke zbritur nga shuma totale e TVSH-së për një periudhë të caktuar tatimore, shumën totale të TVSH-së së zbritshme.

Nëse personi i tatueshëm nuk e zbret TVSH-në e tij të zbritshme në periudhën tatimore kur ndodh ngjarja, ai mundë ta zbres këtë shumë të TVSH-së së zbritshme në çdo kohë pas kësaj periudhe tatimore, mirëpo jo më vonë se në periudhën e fundit tatimore të vitit kalendarik, pas vitit kur ka ndodhur ngjarja.

## Rimbursimi

### ***Çka është dhe si lind?***

Në rastet kur shuma e tatimit të zbritshëm tejkalon obligimin e TVSH-së, lind e drejta e tatimpaguesit për rimbursim. Në momentin që kjo ndodh, tatimpaguesi mund të kërkojë rimbursimin e TVSH-së.

### ***Procedurat për rimbursim të TVSH-së***

Për kërkesat e rimbursimit të TVSH-së duhet të zbatohen procedurat si në vijim:

<sup>12</sup> TVSH e zbritshme – Kur një person i tatueshëm blen mallra apo shërbime nga një person tjetër i tatueshëm, TVSH ngarkohet në cmim dhe njihet si TVSH e Zbritshme

<sup>13</sup> TVSH e ngarkueshme – Kur një person i tatueshëm u shet mallra apo shërbime konsumatorëve, TVSH ngarkohet në cmimin të cilin e paguan konsumatori

- Në fund të secilit tremujor shuma e kreditit të TVSH-së duhet të tejkaloj shumën prej 5,000 €. Në rastet e eksporteve, përveç kësaj rregulle kërkohet që transaksionet e eksportit të pasqyrojnë së paku 25% të transaksioneve totale me të drejtën e zbritjes së TVSH-së.
- Të jenë dorëzuar të gjitha deklaratat e TVSH-së dhe deklaratat e tjera Tatimore për të gjitha periudhat e kaluara. Për eksporte duhet të përmbushen edhe të gjitha dispozitat e aplikueshme doganore.

Nëse ju plotësoni këto kritere, atëher keni të drejtën të parashtroni kërkesën tuaj për rimbursim dhe ate deri me datën 20 të muajit pasues (dmth pas 3 mujorit) . Ate mund ta bëni në këtë mënyrë:

- Vizitoni webfaqen e ATK-së ëëë. [atk-ks.org](http://atk-ks.org);
- Klikoni mbi *Shkarko deklaratë elektronike* (në anën e majtë të faqes);
- Shkruani Numrin tuaj Fiskal dhe
- Tek tabi *Deklarata Tatimore zgjedhni KRR – Kërkesë për rimbursim/ Rikthim/ Kthim*.
- Plotësojeni atë dhe silleni me vete në ATK.

### ***Kur mund të pritni rimbursimin?***

Pas dorëzimit të kërkesës tuaj, ATK do të bëj shqyrtimin e dokumenteve tuaja dhe nëse ato janë të kompletuara ATK në afat brenda 60 ditëve do të bëj rimbursimin tuaj.

Ndërsa në rastet, kur ju si tatimpagues nuk posedoni evidencat dhe dokumentet, ose nëse ka indikacione që të dhënat e raportuara në nuk janë të sakta ATK **nuk** do të bëjë rimbursimin e kërkuar. Procedura të tjera do të hapen për të vazhduar këtë process.

Ndërsa periudha e Rimbursimit për eksportuesit është mujore dhe gjithashtu periudha mujore vlen edhe për kontraktorët e Komisionit Evropian, ndërsa për kontraktoret e USAID-it kjo rregull do te vlej nga 01.01.2012. Përveç kësaj rregulle që periudha është mujore, tek Kontraktoret e Komisionit Evropian dhe USAID-it nuk është e caktuar vlera e kreditimit të mbetur, pra mund të kërkojnë rimbursim pavarësisht vlerës se mbetur si kreditim.

## Faturimi dhe dokumente tjera tatimore

Personi i cili kryen një furnizim të tatueshëm duhet t'i lëshojë një faturë tatimore personit që e pranon mallin lidhur me atë furnizim.

### ***Përmbajtja e një fature***

Në vijim mund të shihni elementet kryesore, duke mos u kufizuar në to, që duhet të përmbajë një faturë e lëshuar nga një person i tatueshëm për një person të tatueshëm si dhe një faturë e lëshuar nga një person i tatueshëm për personin tjetër jo të tatueshëm.

#### ➤ **Personi i tatueshëm për personin tjetër të tatueshëm**

- datën e lëshimit;
- numrin rendor që mundëson identifikimin e faturës;
- numrin e regjistrimit të TVSH-së si dhe numrin fiskal të personit të tatueshëm me të cilin ai furnizon mallra ose shërbime;
- numrin e regjistrimit të TVSH-së si dhe numrin fiskal të klientit apo të blerësit, nëse klienti apo blerësi është i obligueshëm të paguaj TVSH-në në mallrat apo shërbimet e furnizuara për të;
- emrin dhe adresën e plotë të personit të tatueshëm dhe klientit apo blerësit të tij;
- sasinë dhe natyrën e mallrave të furnizuara, ose nivelin dhe natyrën e shërbimeve të bëra,
- datën në të cilën është bërë apo përfunduar furnizimi i mallrave ose shërbimeve, ose datën e pranimit të pagesës në llogari
- shumën e tatueshme në të cilën është ngarkuar TVSH për secilën shkallë individuale ose për të cilën aplikohen lirimet individuale, çmimi i njësisë duke përjashtuar TVSH-në për mallrat apo shërbimet dhe çdo ulje të çmimit dhe zbritje që nuk është përfshirë në çmimin e njësisë;
- normën e aplikuar të TVSH-së;
- shumën e TVSH-së;
- në rast se personi i tatueshëm furnizon mallra ose shërbime për të cilat është paraparë liri nga TVSh, fatura duhet të tregojë dispozitën e këtij Ligji e cila e përcakton atë liri;
- nëse personi i tatueshëm furnizon mallra ose shërbime ku klienti apo blerësi është i obliguar të paguajë TVSH-në, duhet të bëhet referencë në dispozitën e aplikueshme të këtij Ligji ose ndonjë referencë tjetër që tregon se furnizimi i mallrave ose i shërbimeve i nënshtrohet procedurës së ngarkimit të kundërt

## ➤ **Person i tatueshëm për personin tjetër JO TË TATUESHËM**

- datën e lëshimit;
- kohën e furnizimit;
- numrin rendor që mundëson identifikimin e faturës;
- numrin e regjistrimit të TVSH-së dhe numrin fiskal me të cilin personi i tatueshëm furnizon mallra ose shërbime;
- emrin dhe adresën e plotë të personit të tatueshëm;
- emrin e plotë, adresën e “ personit tjetër “ dhe numrin identifikues tatimor të këtij personi siç do të definohet nga ATK;
- shumën totale për pagesë duke përfshirë TVSH-në;
- vlerën e shitjes së mallrave apo shërbimeve pa TVSH, dhe
- shumën e TVSH-së.

### ***Kuponët fiskal***

Çdo person i cili nuk kërkohet të regjistrohet për TVSH, por i cili kryen aktivitet ekonomik obligohet t'i lëshoj pranuesit kuponët fiskal të cilët prodhohen në mënyrë automatike nga pajisjet elektronike fiskale të autorizuara nga Ministria e Financave.

Kuponët fiskal lëshohen për konsumatorët, dmth personat që nuk zhvillojnë aktivitet ekonomik, të cilët blejnë mallra apo shërbime me shumicë apo pakicë. Kuponët fiskal duhet të lëshohen nga të gjitha njësitë apo lokacionet që kryejnë aktivitet ekonomik.<sup>14</sup>

### ***Notat e debitit dhe kreditit***

#### **Çka janë?**

- **Nota e kreditit** lëshohet nga furnizuesi në rastet kur çmimi zvogëlohet pasi të jetë lëshuar fatura tatimore. Kjo mund të ndodhë kur çmimi i mallit është reduktuar për shkak të defektit të gjetur ose kur i jepet zbritje e konsiderueshme.
- **Nota e debitit** lëshohet nga furnizuesi në rastet kur çmimi rritet pasi të jetë lëshuar fatura tatimore. Kjo mund të ndodhë në rastet kur çmimi të jetë llogaritur në shkallë më të ulta se që do të duhej.

---

<sup>14</sup> Shih Shtojcën 3 për të parë se si duket kuponi fiskal

## **Çka duhet të përmbajnë?**

Nota e debitit dhe nota e kreditit duhet së paku të përmbajnë informatat si në vijim:

- datën e lëshimit;
- numrin rendor;
- referencën në faturën origjinale;
- identifikimin e furnizuesit dhe të blerësit: emrin, adresën dhe numrat e tyre fiskal, dhe nëse është e aplikueshme, numrat e tyre të regjistrimit të TVSH-së;
- arsyen e korigjimit, dhe
- shumën e tatueshme të korigjuar dhe TVSH-në e korigjuar.

## ***Fatura e borxhit të keq***

### **Çka është borxhi i keq?**

Kur një biznes nuk është në gjendje të mbledh borxhin e tij dhe në rastet kur të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të mbledhur shumën që që i detyrohet shterren, atëherë ai biznes shumën e detyruar (borxhin) e llogarit si humbje dhe e klasifikon si një shpenzim.

Nëse ndërkohë tatimpaguesi e inkason shumën e borxhit të llogaritur si borxh të keq, duhet të njihet si e hyrë e asaj periudhe në të cilën është inkasuar borxhi.

### **Çfarë duhet të përmbajë fatura e borxhit të keq?**

Fatura e borxhit të keq duhet të përmbajë informatat si në vijim:

- datën e lëshimit;
- numrin rendor;
- referencën në faturën origjinale dhe letrën e aprovuar nga Drejtori apo personi i autorizuar;
- identifikimin e furnizuesit dhe blerësit–borxhliut të keq, numrat e tyre fiskal dhe numrin e tyre të regjistrimit të TVSH-së nëse e posedojnë;
- shumën e tatueshme dhe TVSH-në e faturave origjinale si dhe shumën e korigjuara të vlerës së tatueshme dhe TVSH-së.

## Mbajtja dhe ruajtja e librave të TVSH-së

### **Çka duhet të përmbajë libri i blerjeve?**<sup>15</sup>

- Libri i blerjeve është i detyrueshëm të mbahet nga të gjithë personat e tatueshëm.
- Ai duhet të tregojë në faqen e parë numrin e identifikimit dhe emrin e personit.
- Të gjitha faqet duhet të kenë numër rendor. Libri plotësohet çdo ditë nese ka transaksione. Në të regjistrohen për çdo transaksion furnizimi dhe të dhënat e faturës që paraqet transaksionin .
- Në këtë libër regjistrohet data e lëshimit të faturës, numri rendor i faturës, të dhënat e deklaratës së importit ( nr i DUD),emri i shitësit dhe numri i identifikimit tatimor të tij.
- Blerjet regjistrohen në vlerë totale e cila përfshin edhe TVSH (nëqoftëse ka) si dhe të ndara në blerje me TVSH dhe në blerje pa TVSH.
- Blerjet me TVSH regjistrohen të ndara në importe dhe blerje brenda vendit.
- Për çdo blerje me TVSH personi regjistron vlerën e tatueshme dhe TVSH që i korespondon kësaj blerje.

### **Çka duhet të përmbajë libri i shitjeve?**<sup>16</sup>

- Libri i shitjeve është i detyrueshëm të mbahet nga të gjithë personat e tatueshëm.
- Të gjitha faqet duhet të kenë numër rendor.
- Libri plotësohet çdo ditë nese ka transaksione. Në të regjistrohen për çdo transaksion klienti dhe të dhënat e faturës që paraqet transaksionin.
- Në librin e shitjeve regjistrohen data e lëshimit të faturës, numri rendor i faturës, dhe data e numri i deklaratës doganore kur mallrat eksportohen (nr. i DUD-it), emri i klientit dhe numri i identifikimit të tij.
- Në të regjistrohet vlera totale e transaksionit përfshire TVSH (nëqoftëse ka).
- Shitjet regjistrohen të ndara në të përjashtuara, shitjet me te drejt kreditimi,eksportet dhe shitjet e tatueshme.
- Për çdo shitje të tatueshme regjistrohen vlera e tatueshme dhe TVSH.
- Periudha e ruajtës për librat dhe regjistrimet dhe dokumentet e tjera origjinale të jetë gjashte vjet, ashtu siq eshte paraparë me legjislacionin tatimore te ATK-së.

### **Periudha e ruajtjes së librave**

Personi i tatueshëm duhet të mbajë librat e TVSH-së 6 vite duke filluar pas vitit në të cilin janë mbyllur ato libra. E njejta rregull vlen edhe për librat nëse mbahen në formë elektronike.

<sup>15</sup> Shih Shtojcën 4 për të parë se si duket libri i blerjeve

<sup>16</sup> Shih Shtojcën 5 për të parë se si duket libri i shitjeve

## Deklarata Tatimore kuti për kuti

### *Si të plotësohet?*

Kontabiliteti për qëllime të biznesit shpesh ndryshon nga llogarimbajtja për qëllime tatimore. Kjo do të thotë se informacionet nga pasqyrat financiare të biznesit nuk korrespondojnë saktësisht me vlerat në kutitë e deklaratës së TVSH-së.

ATK, ka formularin e vecantë të TVSH-së, i cili ka shkurtesën TV. Në vijim mund të shihni një formular mostër të TVSH-së si dhe udhëzimet se si te plotësohet ky formular:

### *Si ti shmangemi gabimeve dhe vonesave*

- ✓ Sigurohuni që keni shkarkuar deklaratën e duhur.
- ✓ Bëni të gjitha llogaritjet në euro, asnjë monedhë tjetër nuk është e lejuar.
- ✓ Sigurohuni që humbja të theksohet në kllapa. Për shembull: (200).
- ✓ Kontrolllo për të parë se numri fiskal i shtypur përputhet me numrin tuaj fiskal.
- ✓ Ri-kontrolloni adresën, emrat dhe informatat kontaktuese.
- ✓ Nënshkruani deklaratën; nuk është e vlefshme e pa nënshkruar.
- ✓ Plotësoni të gjitha informacionet e nevojshme; kutitë e zbrazëta mund të vonojnë përpunimin e deklaratës tuaj.



Pjesa e parë: IDENTIFIKIMI

**Kutia [1]**

*Periudha Tatimore:* muaji kalendarik për të cilin ju deklaroni tatimin mbi vlerën e shtuar (për shembull “Shkurt 2011”)

**Kutia [2]**

*UNIREF:* ky barkod i shtypur ka të bëjë me mbajtjen elektronike të të dhënave të ATK-së. Mos shkruani apo shënoni në barkod.

**Kutia [3]**

*Numri Fiskal:* Ky numër do të jetë i shtypur në formularin tuaj.

**Kutia [4]**

*Emri i personit të tatueshëm:* emri ligjor i biznesit apo veprimtarisë, jo emri tregtar.

**Kutia [5]**

*Adresa e personit:* adresa postare e biznesit apo veprimtarisë suaj të personit të tatueshëm.

**Kutia [6]**

*Emri i personit kontaktues:* emri i personit i cili mund të kontaktohet në lidhje me këtë deklaratë.

**Kutia [7]**

*Numri i personit kontaktues:* numri i telefonit të personit i cili mund të kontaktohet në lidhje me këtë deklaratë.

**Kutia [8]**

Vendosni X nga rasti:

- Shtesë:* nëse ju bëni deklaratën e dytë me furnizime shtesë të cilat nuk janë përfshirë në deklaratën e parë të te njëjtës periudhë.
- Korigjim:* nëse keni dorëzuar deklaratën më herët mirëpor keni gabuar në plotësimin e saj.
- Vetëm pagesë:* nëse bëni pagesën e pjesës së papaguar të TVSH-së për periudhën përkatëse.
- Nëse nuk ka transaksione:* nëse ju nuk keni pasur kurrfarë transaksione gjatë kësaj periudhe tatimore të TVSH-së.

Pjesa e dytë: **FURNIZIMET**

**Kutia [9]**

*Furnizimet e përjashtuara pa të drejtë kreditimi:* për të plotësuar këtë kuti ju duhet t'i referoheni Kreut VIII të ligjit të TVSH-së i quajtur: LIRIMET PA TË DREJTËN E ZBRITJES SË TVSH-SË SË ZBRITSHME. Pasi t'i referoheni këtij kapitulli dhe nëse keni furnizime të tilla, ju duhet të vendosni shumën e tyre.

**Kutia [10]**

*Furnizimet e trajtuara si eksporte me të drejtë kreditimi:* për të plotësuar këtë kuti ju duhet t'i referoheni Kreut XII të ligjit të TVSH-së i quajtur: LIRIMET NË LIDHJE ME TRANSAKSIONET E CAKTUARA TË TRAJTUARA SI EKSPORTE, LIRIMET PËR FURNIZIMIN E SHËRBIMEVE NGA NDËRMJETËSUESIT, DHE LIRIMET NË LIDHJE ME ARANZHIMET DOGANORE DHE TË NGJASHME. Pasi t'i referoheni këtij kapitulli dhe nëse keni furnizime të tilla, ju duhet të vendosni shumën e tyre.

**Kutia [11]**

*Eksportet:* në këtë kuti duhet të vendosni shumën e furnizimeve të cilat i përkasin Kreut X të ligjit të TVSH-së i quajtur: LIRIMET NË EKSPORTIM.

**Kutia [12]**

*Shitjet e tatueshme me normën 16%:* në këtë kuti ju duhet të vendosni shumën e furnizimeve të tatueshme me normën 16% të parapara me Ligjin e TVSH-së.

**Kutia [13]**

*TVSH e llogaritur:* Për të plotësuar këtë kuti, ju duhet të vendosni TVSH-në e llogaritur e cila fitohet kur shumëzoni kutinë 12 me 16% ( Kutia 12 X 16% )

**Kutia [14]**

*Nota debitore e lëshuar dhe nota kreditore e pranuar:* Në këtë kuti, vendosni vlerën e notë debitit të lëshuar apo notë kreditit të pranuar.

**Kutia [15]**

*TVSH e llogaritur:* Për të plotësuar këtë kuti, ju duhet të shumëzoni kutinë 14 me 16% ( Kutia 14 X 16% )

**Kutia [16]**

*Fatura e borxhit të keq e pranuar dhe inkasimi I B.K:* në këtë kuti ju duhet të vendosni shumën e faturës së borxhit të keq të pranuar apo atij të inkasuar.

### **Kutia [17]**

*TVSH e llogaritur:* Për të plotësuar këtë kuti, ju duhet të shumëzoni kutinë 16 me 16% ( Kutia 16 X 16% )

### **Kutia [18]**

*Rregullimet për të rritur TVSH-në për pagesë:* Në këtë kuti, ju duhet të vendosni shumën e rregullimeve për të ngritur TVSH-në për pagesë siç është paraparë në nenin 39 të Ligjit TVSH-së i quajtur: Llogaritja e pjesës së TVSH-së së zbritshme që lejohet si e zbritshme. Kjo mund të vendoset edhe për arsye tjera të mundshme.

### **Kutia [19]**

*TVSH e llogaritur:* Për të plotësuar këtë kuti, ju duhet të shumëzoni kutinë 18 me 16% ( Kutia 18 X 16% )

### **Kutia [20]**

*Blerjet që i nënshtrohen ngarkesës së kundërt:* Në këtë kuti, ju duhet të vendosni vlerën e blerjeve me ngarkesë të kundërt ashtu siç është e paraparë me nenin 52 të ligjit të TVSH-së i quajtur Personat e obligueshëm për të paguar TVSH-në, përkatësisht duhet t'i referoheni paragrafit 1.2 , 1.3 dhe 1.4 të këtij neni.

### **Kutia [21]**

*TVSH e llogaritur:* Për të plotësuar këtë kuti, ju duhet të shumëzoni kutinë 20 me 16% ( Kutia 20 X 16% )

### **Kutia [22]**

*Totali i TVSh-së së llogaritur:* Për të plotësuar këtë kuti, ju duhet të mbledhni Kutitë në vijim: [13 ]+ [15] + [17] +[19] + [21] dhe të vendosni totalin.

Pjesa e tretë: **Blerjet**

### **Kutia [23]**

*Blerjet dhe importet pa TVSH:* Në këtë kuti, ju duhet të vendosni shumën e blerjeve vendore dhe mporteve për të cilat nuk është llogaritur TVSH.

### **Kutia [24]**

*Blerjet dhe importet investive pa TVSH:* Në këtë kuti, ju duhet të vendosni shumën e blerjeve vendore dhe importeve të cilat do të përdoren për investime dhe për të cilat nuk llogaritet TVSH.

### **Kutia [25]**

*Blerjet dhe importet me TVSH jo të zbritshme:* Në këtë kuti, ju duhet të vendosni shumën e blerjeve vendore apo importeve për të cilat është llogaritur TVSH mirëpo nuk keni të drejtë të zbritjes së asaj TVSH-je.

### **Kutia [26]**

*Blerjet dhe importet investive me TVSH jo të zbritshme:* Në këtë kuti, ju duhet të vendosni shumën e blerjeve vendore apo importeve për të cilat është llogaritur TVSH mirëpo nuk keni të drejtë të kreditimit të asaj TVSH-je si dhe të cilat do të përdoren për investime.

### **Kutia [27]**

*Importet e tatueshme:* Në këtë kuti, ju duhet të vendosni shumën e importeve për të cilat është llogaritur TVSH dhe për të cilat keni të drejtë të njihni kreditimin e TVSH-së.

### **Kutia [28]**

*TVSH e zbritshme:* Për të plotësuar këtë kuti, ju duhet të shumëzoni kutinë 27 me 16% ( Kutia 27 X 16% )

### **Kutia [29]**

*Importet investive të tatueshme:* Për të plotësuar këtë kuti, ju duhet të vendosni shumën e importeve që do të përdoren për investime dhe për të cilat është llogaritur TVSH e që keni të drejtë të kreditimit të TVSH-së

### **Kutia [30]**

*TVSH e zbritshme:* Për të plotësuar këtë kuti, ju duhet të shumëzoni kutinë 29 me 16% ( Kutia 29 X 16% )

### **Kutia [31]**

*Blerjet e tatueshme vendore:* Në këtë kuti vendosni shumën e blerjeve vendore për të cilat është llogaritur TVSH dhe për të cilat keni të drejtë të njihni kreditimin e TVSH-së.

### **Kutia [32]**

*TVSH e zbritshme:* Për të plotësuar këtë kuti, ju duhet të shumëzoni kutinë 31 me 16% ( Kutia 31 X 16% )

### **Kutia [33]**

*Blerjet investive të tatueshme vendore:* Në këtë kuti vendosni shumën e blerjeve vendore të cilat do të përdoren për investime, për të cilat është llogaritur TVSH dhe për të cilat keni të drejtë të njihni kreditimin e TVSH-së.

#### **Kutia [34]**

*TVSH e zbritshme:* Për të plotësuar këtë kuti, ju duhet të shumëzoni kutinë 33 me 16% ( Kutia 33 X 16% )

#### **Kutia [35]**

*Nota debitore e pranuar dhe nota kreditore e lëshuar:* Në këtë kuti, vendosni vlerën e notë debitit të pranuar apo notë kreditit të lëshuar.

#### **Kutia [36]**

*TVSH e zbritshme:* Për të plotësuar këtë kuti, ju duhet të shumëzoni kutinë 35 me 16% ( Kutia 35 X 16% )

#### **Kutia [37]**

*Fatura e borxhit të keq e lëshuar dhe pagesa e B.K.:* Në këtë kuti, vendosni shumën e faturës së borxhit të keq të lëshuar apo shumën e pagesës së Borxhit të keq.

#### **Kutia [38]**

*TVSH e zbritshme:* Për të plotësuar këtë kuti, ju duhet të shumëzoni kutinë 37 me 16% ( Kutia 37 X 16% )

#### **Kutia [39]**

*Rregullimet për të ulur TVSH-në për pagesë:* Në këtë kuti, ju duhet të vendosni shumën e rregullimeve për të ulur TVSH-në për pagesë siç është paraparë në nenin 39 të Ligjit TVSH-së i quajtur: Llogaritja e pjesës së TVSH-së së zbritshme që lejohet si e zbritshme. Kjo mund të vendoset edhe për arsye tjera të mundshme.

#### **Kutia [40]**

*TVSH e zbritshme:* Për të plotësuar këtë kuti, ju duhet të shumëzoni kutinë 39 me 16% ( Kutia 39 X 16% )

#### **Kutia [41]**

*E drejta e kreditimit të TVSH-së në lidhje me ngarkesën e kundërt:* Në këtë kuti, ju duhet të vendosni vlerën e blerjeve me ngarkesë të kundërt për të cilat ju keni të drejtën e njohjes së Kreditimit të TVSH-së ashtu siç është e paraparë me nenin 52 të ligjit të TVSH-së i quajtur Personat e obligueshëm për të paguar TVSH-në, përkatësisht duhet t'i referoheni paragrafit 1.2 , 1.3 dhe 1.4 të këtij neni.

### **Kutia [42]**

*TVSH e zbritshme:* Për të plotësuar këtë kuti, ju duhet të shumëzoni kutinë 41 me 16% ( Kutia 41 X 16% )

### **Kutia [43]**

*Totali i TVSh-së së zbritshme:* Për të plotësuar këtë kuti, ju duhet të mbledhni Kutitë në vijim: [28 ]+ [30] + [32] +[34] + [36] + [38] + [40] + [42] dhe të vendosni totalin.

Pjesa e katërt: **KALKULIMI**

### **Kutia [44]**

*Teprica a Tvsh-së e bartur nga muaji i kaluar:* Në këtë kuti, ju duhet të vendosni shumën e TVSH-së e cila është kreditim i mbetur në muajin e kaluar. Shih Kutia [47] të deklaratës për periudhën paraprake.

### **Kutia [45]**

*Balanca kreditore e mbetur 45 = ((43+44)-22)>0:* Nëse vlera e Kutive: ( [43]+ [44] )- [22] është më e madhe se 0, përkatësisht rezultat pozitiv, atëherë ju duhet të vendosni shumën e cila është rezultat i formulës së përshkruar.

### **Kutia [46]**

*Kërkesa për rimbursim:* Në këtë kuti, vendosni shumën e kërkesës për rimbursim duke ju referuar nenit 40 të Ligjit të TVSH-së, i quajtur: Kërkesat për rimbursim të TVSH-së.

### **Kutia [47]**

*Kreditimi i tvsh-së per muajin pasues 47 =(45-46):* Në këtë kuti vendosni vlerën e zbritjeve në mes dy kutive 45 dhe 46, përkatësisht: [45] - [46]= [47]. Këtë shumë duhet ta bartni në kutinë [44] të deklaratës së muajit pasues.

Pjesa e pestë: **Pagesa**

### **Kutia [48]**

*TVSH që duhet të paguhet 48 =(22-43-44)>0:* Nëse vlera e Kutive: [22]-[43]-[44] , është më e adhe se 0, përkatësisht rezultat pozitiv atëherë ju duhet të vendosni shumën e cila është rezultat i formulës së përshkruar dhe që është TVSH që duhet të paguhet me këtë deklaratë.

## Pjesa e parafundit: **Nënshkrimi dhe data**

Pasi t'i plotësoni të gjitha kutitë, nënshkruani dhe vëni datën e Deklaratës Tatimore.

## Pjesa e fundit: **Pjesa e bankës**

Këtë pjesë lëreni të zbrazur që të mbushet nga sportelisi i bankës. Pasi të jenë nënshkruar dhe vulosur nga sportelisi i bankës, të tri kopjet e formularit, sportelisi do t'i mbajë dy kopjet e para dhe do t'u japë kopjen e tretë juve.

***E rëndësishme:*** Mos harroni të plotësoni tri kopje të formularit: 2 për bankën dhe një për juve!

Është e rëndësishme të theksohet se data e dorëzimit në bankë do të skanohet automatikisht nga kompjuterët e ATK-së për të aplikuar apo jo gjobat dhe kamatën për deklaram dhe pagesë të vonuar.

## ***Kur duhet të deklaroni?***

Deklarimi dhe pagesa e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar bëhet më së voni deri në datën 20 të muajit pasues për muajin paraprak, p.sh. deklarata e muajit Korrik, bëhet më së voni deri me datën 20 Gusht të po të njejtit vit. Në rastet kur data 20 është ditë feste apo ditë vikendi, duhet të mirret parasysh dita e ardhshme e punës.

## Pasi ta dorëzoni deklaratën tatimore

### ***Çfarë ndodh me deklaratën pasi të pranohet?***

Kur marrim deklaratën tuaj, ose në një zyrë rajonale të ATK-së apo nga banka ku keni dorëzuar atë, ne bëjmë regjistrimin e informacionit dhe e futim atë në sistemin tonë kompjuterik. Në shumicën e rasteve, deklaratat juaj do të përpunohet brenda 30 ditëve nga dorëzimi. Kompjuteri do të gjej çfarëdo gabimi matematikor. Deklarata mund poashtu të shqyrtohet nga një person i stafit të ATK-së.

ATK-ja do të lëshojë një njoftim të vlerësimit, nëse shuma e tatimit të paguar nuk është e saktë.

### ***Cilat janë ndëshkimet dhe interesi që aplikohet?***

Legjislacioni i jep fuqinë ATK-së për të vënë ndëshkime dhe interes, kur tatimpaguesit nuk i përmbushin detyrimet e tyre në kohën e duhur. Masa të tilla nxisin promovimin e përmbushjes vullnetare të detyrimeve tatimore dhe sigurojnë me kohë mbledhjen efektive të të hyrave. Ndëshkimet dhe kamatat janë gjithashtu një çështje e drejtësisë për dhjetëra mijëra tatimpagues që paguajnë shumën e duhur të tatimeve me kohë.

Sipas ligjit dhe politikës administrative, ATK-ja është e detyruar të administroj dënime me saktësi, qëndrueshmëri, dhe në mënyrë të paanshme. Rrethanat që mund të rezultojnë me dënime dhe kamata përfshijnë:

- Dështimi për të paraqitur deklaratat me kohë
- Pagesat e vonuara
- Dështimi për të mbajtur shënime dhe / ose për t'i vënë ato në dispozicion për ATK-në.

Shumat e gjobave dhe të kamatave janë si më poshtë:

- **Dështimi për të paguar tatimet me kohë** do të rezultojë me një dënim prej 1% të bilancit të tatimit të detyruar për secilin muaj apo pjesë të muajit për të cilën pagesa është vonuar, deri në një maksimum prej 12 muajsh.
- **Dështimi për të paraqitur një deklaratë me kohë** do të rezultojë në paraqitjen e një ndëshkimi për vonesë. Kjo shumë është 5% e tatimit të papaguar për secilin muaj apo pjesë të muajit, deri në 25% të tatimit të papaguar.
- **Interesi do të ngarkohet për shumat e papaguara** prej 1.5% në muaj apo pjesë të muajit nga data kur tatimi nuk është paguar, dhe duke përfshirë datën kur tatimi është paguar.
- **Dështimi për t'u regjistruar për TVSH nëse mos regjistrimi ka ndodhur për shkak të pakujdesisë së personit që kryen shitje të tatueshme** - do të rezultojë ndëshkimi administrativ prej:

- 15% të obligimit të TVSh-së për furnizime me pak se dhjetëmijë 10,000 €
  - 25% të obligimit të TVSh-së për furnizime 10,000 € apo më tepër;
- **Dështimi për të lëshuar një faturë të TVSh-së, ose dokument tjetër që shërben si faturë apo nëse lëshon një faturë të pasaktë**
    - Do të detyrohet për atë ulje në shumën obligative apo atë rritje në shumën e kreditimit të kërkueshëm në lidhje me faturën apo transaksionin, plus një ndëshkim administrativ prej:
      - 15 % ose 25 % - duke u mvarur nga rasti
  - **Dështimi për t'u regjistruar për TVSH me arritjen e pragut të kërkuar me Legjislacion<sup>17</sup> apo mos – bërja publike e Certifikatës së TVSH-së** do të rezultojë me ndëshkimi administrative prej 250 €.
  - **Lejimi i përdorimit të Certifikatës tuaj një personi tjetër** – do të rezultojë ndëshkimi administrativ prej 5.000 € për të dyja palët si dhe rasti do të dërgohet tek Prokurori Publik kompetent për ndjekje penale nga Njësia për Hetime Tatimore.
  - **Kompanitë që nuk mbajnë shënime adekuate** do të ngarkohen me një ndëshkim sipas një shume proporcionale të bazuar në madhësinë e biznesit dhe vlerësimet e ATK-së.

ATK-ja ka të drejtë të mbledh gjoba dhe kamata duke përdorur veprimet e njëjta të zbatimit që vlejné për mbledhjen e borxhit tatimor të papaguar. ATK-ja mund të përdor një varg të veprimeve të zbatimit, duke përfshirë mbajtjen mbi llogaritë bankare, pagesat e bllokuara të të ardhurave nga palët e treta dhe konfiskimin dhe shitjen e pronës dhe pasurisë.

Nën rrethana të kufizuara, ATK-ja mundet të hyjë në një marrëveshje me një tatimpagues për të krijuar një plan me këste për pagesën e borxhit tatimor të papaguar, gjobat dhe kamatat.

Të drejtat e juaja	Obligimet e juaja
Të jeni i informuar, i ndihmuar dhe i dëgjuar	të jeni të sinqertë
për të paguar asnjë tatim më shumë se që keni obligim	të paguani tatimet tuaja me kohë
për të apeluar një vendim kundër jush	bashkëpunoni me zyrtarët e ATK-së
për intimitet dhe konfidencialitet	merrni dhe përdorni numrin fiskal
për siguri në lidhje me procedurat e ATK-së duke përfshirë çdo gjykim ose auditim.	ofroni informata të sakta dhe me kohë

<sup>17</sup> Shih faqe 8 për të mësuar më shumë për pragun e regjistrimit të TVSH-së

## **Çfarë nëse ju auditoheni?**

ATK-ja është e angazhuar për trajtimin e drejtë të të gjithë tatimpaguesve sipas ligjit. Së bashku me fuqinë e saj për të kryer auditime, ATK-ja ka mandat që të përdor metodat e përzgjedhjes së rasteve të cilat *maksimizojnë* analizën si objektiv dhe të *minimizojnë* mundësinë për abuzim të autoritetit të tij.

Kur një tatimpagues apo përfaqësuesi i tij/saj dhe të gjithë të punësuarit kyç janë subjekt të një auditimit, ata duhet të:

- pranojnë një intervistë fillestare nga zyrtarët e ATK-së;
- ti sigurojnë inspektorëve tatimore qasje të plotë në të gjitha objektet përfshirë edhe depot së bashku me të gjitha librat dhe të dhënat, fotokopjen e të gjitha dokumenteve të kërkuara nga inspektorët tatimor;
- vënë në dispozicion stafin për t'ju përgjigjur pyetjeve të inspektorave tatimor.

**ATK është e zotuar për të shërbyer gjithë popullin e Kosovës me integritet, efikasitet dhe drejtë.**

Fushëveprimi i auditimit mund të ndryshojë nga shqyrtimi i një deklaratë tatimore gjashtë vjeçare (kontroll i plotë) për auditimin e një ose më shumë periudhave tatimore (një kontroll të shkurtër ose të pjesshëm të kontrollit). Normalisht, ATK-ja do t'i dërgoj tatimpaguesit një njoftim me shkrim tre ditë para se të filloj kontrollin, për t'i njoftuar në lidhje me qëllimin e kryerjes së kontrollit. Ky njoftim duhet të tregojë datën, vendin, qëllimin dhe kohëzgjatjen e parashikuar të kontrollit, një kërkesë për një takim të parë me tatimpaguesin, kërkesë për informacion specifik që kanë të bëjnë me kontrollin; së bashku me detaje të tjera për fillimin e zhvillimit të procesit. Përgjashtim nga ky rregull mund të përfshijnë rrethanat në të cilat ATK-ja ka të dhëna se një tatimpagues është:

- përpjekur për të fshehur ose shkatërruar provat
- përgatitur të largohet nga vendi
- keq-pasqyrimi i inventarit të mallrave

Udhëzimi Administrativ nr 15/2010 ofron detaje mbi procesin e kontrollit, duke përfshirë të drejtat e tatimpaguesit për t'iu përgjigjur një raporti paraprak të kontrollit dhe për të apeluar një raport përfundimtar të kontrollit.

## **Kur do të më vizitojë një inspektor tatimor?**

Zyrtarët e ATK-së bëjnë vizitë tek tatimpaguesi për shumë arsye, duke përfshirë si vijon:

- Edukimi i tatimpaguesit
- Aplikacionet për numra fiskal
- Aplikacione për licenca për të drejtuar lojërat e fatit
- Pajtueshmëri me arkat fiskale
- Mbledhja e borxhit
- Deklaratat tatimore të pashlyera
- Kontrollat në terren për përmbushjen
- Hetimi i akuzave të supozuara penale tatimore

## Ku të drejtoheni për ndihmë

Ne duam të bëjmë gjithçka të mundshme për të ju ndihmuar në përmbushjen e detyrimeve tatimore. Nëse keni nevojë për më shumë informacione, ne ju inkurajojmë që të shqyrtoni ligjet dhe udhëzimet administrative përkatëse. Këto janë në dispozicion në faqen tonë të internetit në:

[www.atk-ks.org](http://www.atk-ks.org)

Nëse nuk jeni në gjendje për të gjetur përgjigje për pyetjet tuaja, stafi i ATK-së është në dispozicion për të ju ndihmuar.

- Na dërgoni me e-mail pyetjet e juaja në [info@atk-ks.org](mailto:info@atk-ks.org)
- Na thirrni apo vizitoni zyrat tona për edukimin e tatimpaguesve:

<i>NjTM</i>	038/200 346 41	<i>Drejtoria e TAK-ut</i>	038/200 250 17
<i>Pristina 1</i>	038/200 255 21	<i>Ferizaji</i>	0290/321 668
<i>Pristina 2</i>	038/200 255 17	<i>Gjakova</i>	0390/330 021
<i>Prizreni</i>	029/244 963	<i>Gjilani</i>	0280/326 967
<i>Peja</i>	039/432 812	<i>Mitrovica</i>	028/530 059

### ***Sigurimi i informatave për tatimin tuaj***

Informatat e juaj për tatimin janë konfidenciale. Nëse ju duhet të vizitoni apo telefononi zyrën tonë me pyetje specifike rreth deklaratës tuaj, ne MUND t'ju kërkojmë për të identifikuar veten dhe ju do të duhej të përgjigjeni pyetjeve rreth identifikimit.

Ju, gjithashtu mund të autorizoni dikë, të tillë, si një kontabilist apo llogaritar për të përfaqësuar juve për të diskutuar dosjen tuaj. Ai/ajo duhet të ketë autorizimin me shkrim të nënshkruar nga ju, së bashku me identifikimin dhe kopjet e formularëve tatimor. Në të gjitha rastet, ATK-ja zbaton procedurat e rrepta para dhënies së informacionit tuaj ndonjë pale tjetër.

## Pyetje dhe Shembuj praktik

### 1. Si funksionon TVSH-ja: Libri i Shitjes dhe Blerjes

Nga tatimpaguesi që është i regjistruar si deklarues i TVSh-së, kërkohet të mbajë libra dhe regjistrime në pajtim me legjislacionin në fuqi.

#### Libri i Shitjes

Përsoni i tatueshëm, për çdo shitje të mallrave dhe shërbimeve, obligohet të arkëtojë 16 % TVSh nga konsumatori. Konsumatorit duhet t'i lëshohet një faturë për mallra dhe shërbime të shitura dhe /apo kupon fiskal dhe e njejta duhet të regjistrohet në librin e shitjes. Shitjet në të cilat

përlllogaritet TVSh-ja quhen shitjet e tatueshme. Tatimi i arkëtuar nga konsumatori në bazë të Legjislacionit në fuqi quhet TVSh e llogaritur .

$$\text{Vlera e Tatueshme} + \text{TVSh e llogaritur} = \text{Vlera totale}$$
$$10,000 \text{ €} + 1,600 \text{ €} = 11,600 \text{ €}$$

#### Libri i Blerjes

Subjekti i regjistruar si deklarues i TVSh-së, të gjitha blerjet i regjistrojnë në librin e blerjes dhe TVSh-në e paguar në blerje e cila lejohet në bazë të Legjislacionit, do ta shfrytëzojë si TVSh të zbritshme, në raport me TVSh-në e llogaritur.

$$\text{Vlera e Tatueshme} + \text{TVSH e zbritshme} = \text{Vlera totale}$$
$$5,000 \text{ €} + 800 \text{ €} = 5,800 \text{ €}$$

Tatimi i llogaritur është tatimi që arkëtohet nga konsumatori (shitja). Tatimi i zbritshëm është tatimi i cili paguhet në blerje vendore (Blerja nga deklaruesit e TVSh-së) dhe importe. Ndryshimi në mes të TVSh-së së llogaritur dhe TVSh-së së zbritshme do të rezultojë në një TVSh për pagesë ,ose një kreditim..

#### SHEMBULL :

a) Rasti i parë kur tatimpaguesi paguan TVSH-në në fund të periudhës :

	Vlera e tatueshme TVSH	TVSH
TVSH e llogaritur	10,000 €	1,600 €
TVSH e zbritshme	6,000 €	800 €
<b>TVSH për pagesë</b>	<b>16.000 €</b>	<b>800 €</b>

b) Rasti i dytë kur tatimpaguesi është në kreditim të TVSH-së:

	Vlera e tatueshme TVSH	TVSH
TVSH e llogaritur	6,000 €	800 €
TVSH e zbritshme	10,000 €	1,600 €
<b>Balansa Kreditore</b>		<b>800 €</b>

Nuk do të lejohet të shfrytëzohet si TVSh e zbritshme, TVSh-ja e paguar në mallra dhe shërbime të marra për përdorim personal. Do të lejohet të zbritet vetëm tatimi i zbritshëm në mallra dhe shërbime të shfrytëzuara për qëllime biznesi dhe nëse këto mallra dhe shërbime janë përdorur për të kryer furnizime të tatueshme apo furnizime të përjashtuara me të drejtë kreditimi. Furnizimet për biznes përfshijnë mallrat sikurse janë makineria, mobilet, ndërtesat apo shërbimet sikurse janë sigurimi, ndërtimi, pastrimi, kontabiliteti, ruajtja (mbrojtja) etj .

Në rastin kur tatimpaguesi është në kredit (Tatimi i paguar tepër) mund të bartet në periodha vijuese për zbritjen e tatimit të llogaritur, ose mund të rimburohet, nëse plotësohen kushtet e kërkuara me legjislacionin në fuqi. Duhet të ceket se në raste kur kemi të bëjmë me shitjet e përjashtuara kjo rregull ndryshon, sepse për shitjet e përjashtuara nuk lejohet të shfrytëzohet tatimi i paguar në blerje si tatim i zbritshëm .

## ***2. A mund të trajtohet si TVSh e zbritshme TVSh e paguar për vetura luksoze që shfrytëzohet për biznes si dhe nevoja private?***

Në këto raste e drejta për të zbritur TVSh-në e zbritshme lejohet më së shumti vetëm deri në 50% nëse arrihet të prezantohet dokumentocioni në vijim:

- dëshmia mbi blerjen e veturës (faturë ,DUD)
- shpenzimet e ndodhura,
- libri udhëtimit ( duhet shënohen saktë kilometrat nga nisja deri në destinim të fundit, arsyen e udhëtimit)
- çdo dokument tjetër relevant që do të arsyetojë shpenzimet e ndodhur

## ***3. Jam person fizik dhe jam pajisur më Numër Fiskal për shkak se realizoj të ardhura nga dhënia e objekteve afariste me qira. Të ardhurat e mija janë mbi 50, 000 euro brenda 12 muajve, a jam i obliguar të regjistrohem për TVSh dhe të paguaj atë?***

Ju jeni të obliguar të regjistrohen për TVSh brenda 15 ditëve nga dita e arritjes së pragut prej 50,000 euro. Pas kësaj si person i tatueshëm jeni të obliguar të vjelin TVSh në shitje dhe të zbritni TVSh-në e paguar në blerje dhe të paguani në Buxhetin e Republikës.

## ***4. Jam person i tatueshëm për TVSh si dhe jam i interesuar të di për procedurën për shtyrjen e pagesës së TVSh-së më rastin e importimit të mjeteve kryesore?***

Personi i tatueshëm i cili fillon një biznes të ri dhe nëse importon mjete kryesore për biznesin ka të drejtë të kërkojë shtyrje të pagesës së TVSh-së më rastin e importimit të tyre. Shtyerja e pagesës së TVSh-së do të aprovohet personit të tatueshëm nëse plotësohen kushtet si në vijim:

- Garancioni bankar për të mbuluar pjesën e TVSh-së
- Kopjen planit të biznesit
- Kopjen e kontratës ose faturën me shitësin e makinerisë
- Planin e biznesit
- Lejen e ndërtimit të dhënë nga organi kompetent

**5. Jemi një OJQ e Regjistruar në Zyrën për Regjistrim të OJQ-ve, dhe kryesisht mbështesim sektorin e Bujqësisë dhe Blegtorisë në Republikën e Kosovës. Meqenëse ne muajin nëntor nga Komisioni Evropian kemi fituar një projekt i cili financohet nga Komisioni Evropian dhe të cilët na kanë udhëzuar se ky projekt është i liruar nga TVSH mirësisht kërkoj nga ju që të na informoni për këtë?**

Projektet të cilat financohen nga Komisioni Evropian, janë të lira nga TVSh në importe të cilat bëhen për realizimin e këtyre projekteve. Lirimi është paraparë me nenin 26 të Marrëveshjes IPA. Përveç kësaj për këto raste ATK ka nxjerrur një Vendim Shpjegues Publik Nr. 02/2010, ku në nenin 3 të këtij vendimi është rregulluar procedura për tu liruar nga TVSh në importe. Kurse për furnizimet vendore të cilat i keni më qëllim të realizimit të këtyre projekteve ju do të ngarkoheni më TVSh, por e keni të drejtën e rimbursimit të TVSh-së siç është rregulluar me nenin 5 të këtij vendimi.

**6. Si trajtohet transporti ndërkombëtar i pasagjerëve? A duhet të faturohet më TVSh apo jo?**

Në Ligjin Nr. 03/L-146 Për Tatimin Mbi Vlerën e Shtuar, transporti i pasagjerëve duhet të faturohet në proporcion me rrugët e mbuluara në Kosovë. Sipas këtij nën-paragrafi ju si kompani duhet të faturoni më TVSh vetëm për pjesën e transportit e cila kryhet brenda në Kosovë, ndërsa për pjesën e transportit e cila është zhvilluar jashtë Kosovës nuk duhet të faturoni më TVSh.

**7. A duhet të faturohet më TVSh kur ne si Person i tatueshem ofrojmë shërbime për një person tjetër të tatueshem jashtë Kosovës? Pra ky person nuk është i vendosur në Kosovë dhe nuk ka për obligim sipas ligjit të aplikueshëm të regjistrohet në Kosovë.**

Kur transaksioni kryhet në mes të personave të tatueshëm si dhe personi për të cilin kryhet shërbimi nuk është i regjistruar në Kosovë, dhe nëse ofrimi i shërbimeve nuk është në kuadër të rregullave të veçanta që përcaktojnë vendin e furnizimit të shërbimit në këtë rast vendi i furnizimit është vendi ku është vendosur pranuesi i shërbimit, përderisa pranuesi i shërbimit nuk ka krijuar njësi të përhershëm në Kosovë. Për shërbimet që ju bëni për një person të tatueshëm jashtë Kosovës dhe i cili nuk ka krijuar njësi të përhershëm në Kosovë fatura në këto raste duhet të bëhet pa TVSh.

**8. Kompania A ia shet një makinë Kompanisë B. Çmimi i rënë dakord është 30,000 Euro. Me nënshkrimin e kontratës më 15 janar, Kompania A pranon një pagesë paraprake prej 3,000 Euro. Më 28 shkurt makina i dorëzohet Kompanisë B dhe më 1 mars lëshohet fatura, kur duhet të paguhet TVSh?**


TVSh duhet të paguhet si në vijim:

- Më 15 Janar duhet njohur si të hyra 3,000 euro.
- Më 28 Shkurt duhet njohur si të hyra vlerën prej 27,000 euro.

- 9. Një DJ shumë i popullarizuar i shet CD-të e tij në një panair muzikor në Prishtinë. Çmimi për një CD është 10 Euro. Muzika është e krijuar nga ai, dhe këtë CD ai ia ka dedikuar nënës së tij të dashur. A është ky furnizim i shërbimeve apo furnizim i mallrave?**

Këtu kemi të bëjmë me furnizim të mallrave. Furnizimi është bërë fizikisht dhe është përgatitur më herët. Këtu blihet CD-ja e paketuar dhe nuk ka mundësi intervenimi.

## Shtojca 1: Mostra e certifikatës së TVSH-së



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS – VLADA KOSOVA – GOVERNMENT OF KOSOVO  
MINISTRIA E FINANCAVE – MINISTARSTVO ZA FINANSIJE – MINISTRY OF FINANCE  
**ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS - PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA - TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO**

ATK - TAK - PAK

### CERTIFIKATË REGJISTRIMI PËR TVSH UVERENJE REGISTRACIJE ZA PDV VAT REGISTRATION CERTIFICATE

ATK - TAK - PAK

Numri unik i TVSh:  
Jedinstven broj PDV-a:  
VAT Unique Number:

Numri Fiskal:  
Fiskalni Broj:  
Fiscal Number:

Emri i personit të tatueshëm:  
Ime oporezivane osobe:  
Taxable person's name:

Adresa e personit:  
Adresa osobe:  
Person's Address:

Data e regjistrimit:  
Datum registracije:  
Registration Date:

Data e Lëshimit:  
Datum izdavanja:  
Date of Issuance:

Personi përgjegjës:  
Odgovorno lice:  
Responsible person:

ATK - TAK - PAK

Kjo certifikatë është lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës, bazuar në nenin 6 të Ligjit Nr. 03/L-146 Për Tatimin Mbi Vlerën e Shtuar.

Ovaj certifikat izdat je od Poreske Administracije Kosova, shodno članu 6 Zakona Br. 03/L-146 O Porezu na Dodanu Vrednost.

This certificate is issued by the Tax Administration of Kosovo, based on article 6 of the Law Nr. 03/L-146 on Value Added Tax.

ATK - TAK - PAK

VERSIONI - 5 - KORIGJUAR 01-07-2010


Shtojca 2: Mostra e Certifikatës së Eksportit dhe Importit

	
<b>REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO</b> <b>QEVERIA E KOSOVËS – VLADA KOSOVA – GOVERNMENT OF KOSOVO</b> <b>MINISTRIA E FINANCAVE – MINISTARSTVO ZA FINANSIJE – MINISTRY OF FINANCE</b> <b>ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS – PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA – TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO</b>	
<b>CERTIFIKATË PËR IMPORT DHE EKSPORT</b> <b>CERTIFIKAT ZA UVOZ I IZVOZ</b> <b>IMPORT AND EXPORT CERTIFICATE</b>	
<b>Numri rendor:</b> <b>Redni broj:</b> <b>Sequent No.:</b>	<input type="text"/>
<b>Numri Fiskal:</b> <b>Fiskalni broj:</b> <b>Fiscal Number:</b>	<input type="text"/>
<b>Emri i Personit:</b> <b>Ime osobe:</b> <b>Person's name:</b>	<input type="text"/>
<b>Adresa e Personit:</b> <b>Adresa osobe:</b> <b>Person's address:</b>	<input type="text"/>
<b>Data e regjistrimit:</b> <b>Datum registracije:</b> <b>Registration Date:</b>	<input type="text"/>
<b>Data e Lëshimit:</b> <b>Datum izdavanja:</b> <b>Date of Issuance:</b>	<input type="text"/>
<b>Personi përgjegjës:</b> <b>Odgovorno lice:</b> <b>Responsible person:</b>	<input type="text"/>
<p>Certifikata është lëshuar sipas nenit 5 të Ligjit Nr. 03/L-146 Për Tatimin Mbi Vlerën e Shtuar.</p> <p>Certifikat zdat shodno članu 5 Zakona Br. 03/L-146 Za Porez na Dodanu Vrednost.</p> <p>This certificate is issued according to article 5 of the Law No. 03/L-146 on Value Added Tax.</p>	
<small>VERSIONI - 5 - KORIGJUAR 01-07-2010</small>	

### Shtojca 3: Mostra e Kuponit Fiskal

#### Shembull i kuponit fiskal

#### Kuponi standarde

EMRI I TATIMPAGUESIT		
ADRESA		
NUMRI I TELEFONIT:123-456-789		Koka e kuponit
NUMRI FISKAL		
NUMRI I CERTIFIKATËS SE TSH		
Nuk shtypet nëse është e zbrazet		
01	EMRI I OPER. 1	Numri i PEF-it, emri dhe numri i operatorit
2 X 2.50		
QUMSHTE	5,00 A	
3 X 1.50		Përshkrimi i operatorit, sasia, çmimi për njësi dhe total te shoqëruar me shkallen përkatëse te TVSH-se
COCA COLA	4,50 B	
2 X 1.70		
ENERGY DRINK	3.40 C	
TOTALI NE EURO	12,90	Totali ne Euro
PARA TE GATSHME	12.00	Forma e pagesës
TVSH B 15%	0.59	Vlera për shkalle te VAT
TVSH C 20%	0,57	
TOT. PA TVSH	11,74	Vlera pa TVSH
000463	ARTIKUJ 3	Numri i kuponit dhe numri i artikujve
29-06-2009	11:33	Data dhe koha
NR. SERIK	LA02345678	ID e PEF-t
KUPON FISKAL NR. 20		Njoftim i kuponit fiskal
		Logoja fiskale


#### Shtojca 4: Mostra e librit të blerjes së blerjes

Fatura				Numri i TVSh-së së shitësit	Blerja totale me TVSh	Blerja pa TVSh e me TVSh të pazbritshme	Blerjet që i nënshtrohen TVSH-së			
Data	Numri	Emri i Shitësit	Numri fiskal i shitësit				Importet		Blerjet vendore	
							Vlera e tatueshme	TVSh	Vlera e tatueshme	TVSh
a	b	c	d	e	f=g+h+j	g	h	i	j	k
Gjithsej										

### Shtojca 5: Mostra e librit të shitjes

Fatura				Shitjet totale	Furnizimet e Përfunduar	Furnizimet e Tatueshme		
Data	Numri	Blerësi	Numri fiskal i blerësit			Furnizimet me te drejte kreditimi Daljet dhe Eksportet	Furnizimet e tatueshme me 16%	TVSh
a	b	c	d	e=f+g+h	f	g	h	i
Gjithsej								

**A e njihni EDI-n?**



PYETJE dhe PËRGJIGJE Të SHPESHTA

***EDI, gjithmonë në shërbim për lehtësim në deklaram!***

## Info të përgjithshme

### 1. Kush është EDI?

EDI është shkurtësë e fjalës deklarim elektronik apo E- deklarimi.

### 2. Pse duhet ta njoh EDI-n?

EDI është një mënyrë modern, e shpejtë dhe e thjeshtë për të deklaruar tatimin. Ky sistem u lejon të krijoni një llogari online me ATK-në, ku ju mund të plotësoni dhe deklaroni deklaratat tatimore si dhe të kontrolloni historinë tuaj tatimore.

### 3. Kush mund ta përdor EDI-n?

EDI do të hyj në funksion gjatë vitit 2011. Që nga Gushti vitit 2011, EDI do të jetë në dispozicion për bizneset që janë të kategorizuara në Njësinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj – NJTM, ndërsa nga fundi i vitit 2011, të gjitha bizneset do të mund të përdorin EDI-n. Sa u takon tatimpaguesve të tjerë, ata do të kenë mundësi të përdorin EDI-n nga fillim i vitit 2012.

### 4. Cilat janë përparësitë e EDI -t?

- Ju mundëson të keni casje në historinë tuaj tatimore.
- EDI ju kursen kosto administrative si në kohë ashtu edhe në burime njerëzore.
- Redukton numrin e vizitave në zyrat e ATK-së.
- Ju mund të plotësoni deklaratat tatimore në kompjuter dhe t'i dorëzoni ato nëpërmjet internetit 24 orë në ditë, 7 ditë në javë e 365 ditë në vit.
- Dorëzimi është i menjëhershëm, i besueshëm dhe i sigurt.
- Procesimi i deklaratave do të jetë më i shpejtë.
- Procesimi elektronik zvogëlon rrezikun nga gabimet.

### 5. Çfarë shërbime ofron EDI?

- Deklarimin e Tatimit
- Printimin e të dhënave tuaja tatimore
- Kontrollimin e historisë dhe bilancit tuaj tatimor
- Ndryshimin e kontakteve tua
- Caktimin e profesionistit tatimor

### 6. Si ta takoj EDI-n?

Duhet të vizitoni zyret tuaja regjionale të ATK-së për t'u njoftuar me te dhe me më shumë detaje rreth tij.

### 7. Çfarë tatimesh mund të deklaroj me EDI-n?

Momentalisht me EDI-n mund të bëni vetëm deklarimin e Tatimit mbi vlerën e shtuar. Shumë shpejt EDI do t'ju mundësoj të bëni edhe deklarimin e tatimeve tjera.

### **8. A ndryshojnë deklaratat tatimore elektronike nga ato në letër?**

Jo. Format i deklaratave tatimore që plotësohen nëpërmjet internetit është i njëjtë me ato fizike.

### **9. Si dhe ku të marr ndihmë në lidhje me deklarin elektronik të tatimeve?**

Për të marrë ndihmë, ju mund të klikoni tabin Ndhimë dhe të zgjidhni llojin e ndihmës që ju kërkoni. Në këtë tab ofrohen Pyetje të shpeshta në lidhje me EDI-n, udhëzime e doracak për të plotësuar formularët tatimor apo gjithashtu mund të kërkoni ndihmë direkt nga stafi i ATK-së. Ju gjithashtu mund të drejtoheni tek zyra juaj regjionale tatimore apo të shkruani e-mail në [hasime.shabanaj@atk-ks.org](mailto:hasime.shabanaj@atk-ks.org)

## **Përdorimi i EDI-t**

### **10. A duhet të paguaj për të përdorur shërbimet që ofron EDI?**

Jo. Të gjitha shërbime që ofron EDI janë pa pagesë.

### **11. Cilat janë afatet e fundit për të deklaruar me EDI-n?**

Afatet janë të njëjta siç kanë qenë deri më tani, pra të përcaktuara me Legjislacionin Tatimore të Kosovës.

### **12. A do t'më mbyllet EDI automatikisht pas një kohë të caktuar?**

Po, për çështje sigurie EDI do të mbyllet automatikisht pas 15 min në rast të mos përdorimit të tij.

### **13. A mund të përdoret EDI për të deklaruar tatimet e viteve të mëparshme?**

Jo. EDI nuk ua lejon të bëni deklarin e tatimeve të viteve të mëparshme. EDI lejon deklarin e tatimit për vitin 2011 e më tutje. Për të bërë deklarin e tatimeve të viteve paraprake ju duhet të shkarkoni formularin tatimor nga ueb faqja e ATK-së: [www.atk-ks.org](http://www.atk-ks.org)

### **14. A mund të ndryshojë një deklaratë të mëparshme përmes EDI-t?**

Jo, korrigjimet nuk mund të bëhen përmes EDI-t. Ju duhet të vizitoni zyret lokale të ATK-së për të ndryshuar apo korrigjuar deklaratat tatimore.

### **15. Si mund ta di që kam deklaruar në mënyrë të suksesshme?**

Pasi të keni përfunduar deklarin, juve do t'ju paraqitet mesazhi: Deklarimi i juaj u krye në mënyrë të suksesshme.

### **16. A të lejon sistemi të shohësh historinë e tatimeve të paguara në formë elektronike?**

Po. Tatimpaguesit që kanë deklaruar tatimet e tyre, kanë mundësinë të shohin historikun e veprimeve që ata kanë kryer nëpërmjet dosjes së tyre elektronike tatimore.

### **17. A shkycet EDI automatikisht nëse unë e harroj hapur?**

Po EDI shkycet automatikisht brenda 15 minutave nëse ju nuk e përdorni ate dhe e leni hapur.

## 18. Si të kyçem tek EDI?

Hyni në faqen zyrtare të internetit të ATK-së në adresën: [www.atk-ks.org](http://www.atk-ks.org).

Në të majtë të ekranit, nën titullin “Shërbimet elektronike”, klikoni mbi “EDI” që është e para në listë. Në ekran do të shfaqet dritarja që shërben për të hyrë në sistemin e deklarimit elektronik të tatimeve.

Shkruani Numrin tuaj Fiskal, fjalëkalimin e marrë nga ATK, numrin që shfaqet në TOKEN – in që e keni marrë nga ATK dhe shtypni butonin log in (hyr) ku do të hyni në faqen bazë të EDI-t.

Në pjesën e sipërme të faqes do të gjeni katër mundësi: (i) Deklarata Tatimore, (ii) Raportet, (iii) Profili juaj dhe (iv) Ndhimë.

- Klikoni mbi *Deklarata Tatimore* për të deklaruar tatimin, për të *parë Deklaratat e papaguara*, për të *Ngarkuar dokumente* si dhe për të parë e printuar *Deklarimet e fundit*.
- Klikoni mbi *Raportet* për të parë *Historinë e Deklarimeve* dhe *Bilancin Tatimor*.
- Klikoni mbi *Profili Juaj*, për të *Ndryshuar profilin*, *Ndryshuar fjalëkalimin* dhe për të *Caktuar personin e autorizuar për deklarim*.
- Klikoni mbi *Ndhimë* për të marrë më shumë informata rreth *EDI-t*, udhëzime e doracak rreth *plotësimin të deklaratave tatimore*, për të parë *përgjigjet e Pyetjeve të shpeshta* dhe për të *Kërkuar ndihmë drejtpërdrejt nga stafi i ATK-së*.
- Siguria dhe konfidencialitetit

## 19. Si mund të sigurohem që të dhënat e mia janë të sigurta?

Informacioni që futet në këtë sistem është i njëjtë me atë të dërguar në mënyrën tradicionale shkresore, por niveli i sigurisë është shumë më i lartë, kjo për arsye se ekzistojnë rregulla të qarta dhe të prera për sa i përket procedurave të hyrjes në serverin ku ai ndodhet. Të gjitha të dhënat janë të koduara duke përdorur SSL teknologjinë si dhe të gjitha veprimet që kryhen lenë gjurmë dhe mund të kontrollohen në çdo kohë. I gjithë informacioni që ndodhet në sistem ruhet në një kopje të dytë për raste problemesh.

## 20. A ruhen deklaratat e mia në konfidencialitet?

Të gjitha komunikimet që kryhen në EDI janë të enkriptuara në bazë të standardeve ndërkombëtare si dhe në përputhje me Statutin e Tatimpaguesit të Kosovës i cili i jep çdo tatimpagues të drejtën për privatësinë dhe konfidencialitetin e informatave të tij / saj tatimore.

## Pagesat

### 21. Si të bëj pagesën e tatimit tim?

Pasi të deklaroni tatimin tuaj, ju duhet të printoni deklaratën tatimore dhe të drejtoheni në Bankën tuaj komerciale për të bërë pagesën e tatimit. Në të ardhmen e afërt, do të ofrohet mundësia e pagesës në mënyrë elektronike përmes të gjitha Bankave Komerciale që veprojnë në vendin tonë.

## Personi i autorizuar për deklarim

### 22. A mund të autorizoj kontabilistin tim apo dikë tjetër të deklaroj në emrin tim?

Po mundeni. Ju duhet të klikoni mbi tabin Profili juaj dhe të zgjidhni butonin *Cakto personin e autorizuar për deklaram*.

**23. A duhet Personi i Autorizuar të përdor EDI –n në mënyrë që të autorizohet nga unë?**

Po personi i autorizuar duhet patjetër të jetë i regjistruar për të përdorur EDI-n, në mënyrë që të ketë mundësi të bëjë deklaramin e biznesi tuaj. Ai duhet të vizitojë zyrën lokale të ATK-së për të marrë tokenin dhe informatat tjera.

**24. A mundem unë të kontrolloj bilancin tim tatimor pasi që të kem autorizuar personin për deklaram?**

Po, ju do të mund të kontrolloni bilancin tuaj tatimor 24 orë në ditë, 7 ditë në javë e 365 ditë në vit edhe nëse keni autorizuar dikë tjetër të deklaroj për biznesin tuaj. Për të bërë këtë juve do të ju duhet tokeni që keni marrë nga ATK, fjalëkalimi dhe NRF.

Tokeni

**25. Çka nëse e humbas tokenin?**

Nëse e humbisni tokenin, ju duhet të vini në zyrën tuaj lokale të ATK-së sa më shpejtë që të jetë e mundur dhe ta lajmëroni humbjen e tij. Më pastaj ATK, do të ju pajis me një token të ri.

**26. A ka tokeni afat skadimi?**

Po, tokeni ka afat skadimi dhe me rastin e marrjes së tij ATK do t'ju njoftoj për të.

A mundem të përdor tokenin e ndokujt tjetër për tu kyçur në llogarinë time?

Jo nuk mundeni. Secili tatimpagues duhet të ketë tokenin personal për të pasur mundësi të kyçet në llogarinë personale tatimore.

***EDI, gjithmonë në shërbim për lehtësim në deklaram!***

Lajmëroni rastet e evazionit tatimor,  
korrupsionin,  
apo sjelljet jo të mira nga stafi i ATK-së nëpërmjet:

